



**KODI I MIRËSJELLJES  
I BANKËS EKONOMIKE**

---

## **PËRMBAJTJA**

<b>1.0. QËLLIMI</b> .....	3
<b>2.0. PAJTUESHMËRIA, MONITORIMI DHE SHQYRTIMI</b> .....	3
<b>3.0. ZBATIMI I LIGJIT</b> .....	3
<b>4.0. DEKLARATA KORPORATIVE</b> .....	3
<b>4.1. Vizioni</b> .....	3
<b>4.2. Misioni</b> .....	3
<b>4.3. Vlerat tona</b> .....	4
<b>4.4. Vlerat e punonjësve</b> .....	4
4.4.1. Integriteti dhe besueshmëria.....	4
4.4.2. Profesionalizmi dhe kompetenca.....	4
4.4.3. Mbrojtja nga diskriminimi, ngacmimi dhe trajtimi i pabarabartë.....	4
4.4.4. Shërbimi cilësor ndaj klientit.....	5
4.4.5. Paanshmëria.....	5
4.4.6. Paragjykimet.....	5
<b>5.0. KONFIDENCIALITETI DHE ZBULIMI I INFORMACIONEVE</b> .....	5
<b>5.1. Keqpërdorimi i pozitës</b> .....	6
<b>5.2. Konkurrenca</b> .....	6
<b>6.0. RAPORTET ME KLIENTIN</b> .....	6
<b>6.1. Shërbimi ndaj klientit</b> .....	6
<b>6.2. Produktet dhe proceset</b> .....	6
<b>6.3. Transparenca</b> .....	7
<b>6.4. Mbrojtja e të dhënave personale</b> .....	7
<b>6.5. Referimi i klientëve</b> .....	7
<b>7.0. KONFLIKTI I INTERESIT</b> .....	7
<b>7.1. Kontributet politike</b> .....	7
<b>7.2. Trajtimi i konfliktit të interesit për punonjësit e Bankës</b> .....	8
<b>7.3. Dhuratat dhe korrupsioni/mitosja</b> .....	8
<b>7.4. Prokurimi dhe administrata</b> .....	8
<b>8.0. SIGURIA DHE VAZHDIMËSIA E BIZNESIT</b> .....	8
<b>8.1. Ambienti, shëndeti dhe siguria</b> .....	8
<b>8.2. Vazhdimësia e biznesit</b> .....	8
<b>9.0. PARANDALIMI I PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT</b> .....	9
<b>10.0. QËNDRUESHMËRIA</b> .....	9
<b>11.0. PUNËSIMI</b> .....	9
<b>11.1. Aktivitetet dhe marrëdhëniet jashtë Bankës Ekonomike</b> .....	9
<b>11.2. Aktivitetet pas ndërprerjes së punësimit në Bankën Ekonomike</b> .....	9
<b>12.0. SHKELJET E KODIT TË MIRËSJELLJES</b> .....	9
<b>12.1. Detyrimi për t'i raportuar shkeljet</b> .....	9

## 1.0. QËLLIMI

Kodi i Mirësjelljes i Bankës Ekonomike ka për qëllim të përcaktojë parimet bazë të etikës dhe sjelljes të cilat duhet të zbatohen nga të gjithë punonjësit e Bankës gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësisive të tyre.

Ky kod, ndër të tjera, ka për qëllim të promovojë:

- respektimin dhe zbatimin e të gjitha ligjeve, politikave, procedurave dhe të gjitha dokumenteve tjera në fuqi;
- integritetin, ndershmërinë dhe sjelljen etike;
- një ambient pune të respektueshëm nga të gjithë;
- raportim për të gjitha shkeljet e evidentuara;

## 2.0. PAJTUESHMËRIA, MONITORIMI DHE SHQYRTIMI

Banka Ekonomike gjithmonë vepron në atë mënyrë që në çdo rast të jetë plotësisht në pajtueshmëri me ligjet, rregulloret dhe politikat. Gjithashtu kujdeset që të gjithë të punësuarit të veprojnë me standarde të larta të etikës dhe të përmbahen nga çdo formë e sjelljes në kundërshtim me ligjet, rregulloret dhe politikat në fuqi.

Nga të gjithë punonjësit e Bankës Ekonomike pritet që t'i përmbushin obligimet dhe t'i zhvillojnë aktivitetet e tyre në pajtueshmëri me të gjitha ligjet dhe rregulloret duke i zbatuar politikat, procedurat dhe dokumentet e tjera të brendshme të Bankës.

Nga të gjithë punonjësit e Bankës pritet që të respektojnë hierarkinë brenda Bankës.

Nga të gjithë punonjësit e Bankës pritet që t'i shërbejnë klientët pa dallime dhe pa anime, me standarde të larta të etikës dhe mirësjelljes.

Shkelja e parimeve etike dhe e rregullave të sjelljes të vendosura në këtë kod është e ndaluar.

Çdo veprim në kundërshtim me rregullat e këtij kodi mund të rezultojë me veprime konkrete disiplinore ndaj punonjësit që kryen shkeljen, deri në ndërprerjen e punësimit.

## 3.0. ZBATIMI I LIGJIT

Nuk duhet të silleni në atë mënyrë që, për shkaqe personale ose të dikujt tjetër, të shkelen rregullat e Bankës Ekonomike dhe të shkelen të gjitha ligjet e aplikueshme në Kosovë.

Çdo punonjës i Bankës Ekonomike, duke përfshirë edhe Bordin e Drejtorëve dhe menaxhmentin e lartë, është i obliguar që gjatë gjithë periudhës së punësimit në këtë bankë të veprojnë në përputhje të plotë me të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. Mungesa e informimit nuk konsiderohet alibi apo mbrojtje kur dikush në institucion shkel ligjet.

## 4.0. DEKLARATA KORPORATIVE

### 4.1. Vizioni

Bankë e orientuar në rritje të qëndrueshme dhe kualitative, shërbime cilësore dhe standarde të larta profesionale.

### 4.2. Misioni

Bankë vendore MODEL që u:

- Mundëson klientëve qasje të lehtë dhe të shpejtë tek produktet e diversifikuara bankare, duke ngritur vlerën për klientët, të punësuarit dhe aksionarët;
- Ofron klientëve shërbime elektronike bankare moderne;
- Determnuese (e përkushtuar) për ngritje profesionale për të punësuarit tanë;
- Etika, respekti dhe puna ekipore janë vlerat tona;
- Ligjet, politikat dhe procedurat respektohen me përpikëri!

### 4.3. Vlerat tona

Ne karakterizohemi nga PUNA EKIPORE, përmes së cilës i përmbushim nevojat e klientëve tanë. Puna ekipore na sjellë respekt të ndërsjellë, marrëdhënie më të mira ndërnjerëzore dhe fuqizim drejt arritjes së objektivave tanë të përbashkët.

Ne karakterizohemi nga RESPEKTI për njëri-tjetrin dhe RESPEKTI për klientët.

Ne karakterizohemi dhe jemi të angazhuar për standarde të larta ETIKE dhe profesionale, duke demonstruar sjellje të ndershme, profesionale dhe etike në marrëdhëniet tona me kolegët, klientët dhe shoqërinë.

### 4.4. Vlerat e punonjësve

#### 4.4.1. Integriteti dhe besueshmëria

Punonjësit e Bankës Ekonomike duhet të ruajnë integritetin dhe pavarësinë e Bankës.

Gjatë kryerjes së detyrave profesionale si dhe veprimtarive profesionale, punonjësi demonstroi standardet më të larta të integritetit personal dhe ndershmërisë dhe vërtetësisë.

Punonjësit e Bankës Ekonomike janë persona të respektueshëm dhe me integritet të lartë profesional dhe moral, dhe në çdo moment veprojnë në pajtim të plotë me rregullat e këtij kodi.

Sjellja në vijim ndikon negativisht mbi integritetin personal dhe ndershmërinë e stafit:

- Mosrespektimi i orarit të punës
- Shënimi i një date të mëparshme në dokumentet e brendshme apo të jashtme (që u jepen klientëve, kontraktuesve etj.)
- Deklarimet e rrejshme për kompensim për punë jashtë orarit, kilometrazh apo shpenzime të tjera.
- Keqpërdorimi i kompjuterit, internetit, telefonit, faksit, printerit/fotokopjuesit.
- Marrja e dokumenteve të Bankës nga zyra për përdorim privat në shtëpi.

Punonjësit e Bankës Ekonomike janë persona me integritet të lartë dhe në çdo situatë, si në raportet mes kolegësh ashtu edhe me klientët apo kontraktuesit tjerë, veprojnë në mënyrë të ndershme dhe në pajtim me këtë kod.

#### 4.4.2. Profesionalizmi dhe kompetenca

Gjatë kryerjes së detyrave të tyre profesionale, sjellja e stafit ndaj klientëve pa dallime dhe punonjësve të tjerë të Bankës duhet të jetë me respekt, me kujdes, me durim, e drejtë, e ndërgjegjshme dhe brenda afateve kohore.

Punonjësit duhet të përmbahen nga sjellja joetike apo joprofesionale e cila do të ndikonte negativisht në imazhin profesional të dikujt dhe do të rezultonte në humbjen e dinjitetit të stafit si dhe do të dëmtonte rëndë reputacionin e Bankës Ekonomike.

Punonjësi do t'i shërbejë Bankës me ndjenjë të besnikërisë dhe do t'i përmbushë detyrat profesionale në mirëbesim dhe përkushtim ndaj përgjegjësisë së vet në atë mënyrë që të promovojë vlerësimin e publikut për shërbimet e Bankës Ekonomike.

Stafi do të demonstrojë në çdo kohë kompetencë profesionale dhe do të përpiqet të vijojë zhvillim të vazhdueshëm profesional.

Nga punonjësit kërkohet që t'i njohin kërkesat që dalin nga politikat, procedurat dhe dokumentet e tjera në fuqi varësisht nga pozita që mbajnë në Bankë. Punonjësit duhet të kenë njohuri për veprimet mbi ndryshimet e dokumenteve të brendshme dhe vendimet nga hierarkia më e lartë të cilat ndikojnë në punën e secilit prej tyre në Bankë.

#### 4.4.3. Mbrojtja nga diskriminimi, ngacmimi dhe trajtimi i pabarabartë

Banka Ekonomike angazhohet maksimalisht për të krijuar një ambient pune të respektueshëm për të gjithë punonjësit, dhe nuk toleron në asnjë rast asnjë lloj diskriminimi, ngacmimi apo trajtimi të pabarabartë, i cili bie ndesh me dispozitat e këtij kodi si dhe legjislacionin përkatës në fuqi për mbrojtje nga diskriminimi.

Me qëllim të evitimit të kësaj dukurie, të gjithë punonjësit e Bankës Ekonomike do të tregohen të kujdesshëm dhe nuk do të përdorin fjalë ofenduese ndaj kolegëve të tyre e as nuk do shfaqin ndonjë sjellje e cila mund të konsiderohet si diskriminuese apo trajtim i pabarabartë ndaj kolegut.

Të gjithë punonjësit e Bankës Ekonomike, me rastin e ushtrimit të pozitës së tyre, veprojnë në përputhje me detyrat dhe obligimet e tyre, dhe në asnjë moment nuk do ta shfrytëzojnë apo keqpërdorin pozitën e tyre për përfitime të tyre personale, apo për realizimin e ndonjë qëllimi të caktuar.

Punonjësit e Bankës Ekonomike i respektojnë mendimet e të tjerëve, dinjitetin e tyre personal, intimitetin dhe të drejtat individuale. Prandaj, nuk tolerojmë asnjë lloj diskriminimi dhe ngacmimi, si për shembull në llogari të kombësisë, kulturës, religjionit, ngjyrës së lëkurës, orientimit seksual, moshës ose paaftësisë fizike të personit.

Marrja në punë, ngritja në detyrë, promovimi dhe vlerësimi i punonjësve bazohet ekskluzivisht në kriteret e orientuara në përmbushjen e detyrave që përcaktohen me rregulloret e punës, duke përfshirë arritjen e objektivave të dakorduar ose përvojën profesionale.

#### **4.4.4. Shërbimi cilësor ndaj klientit**

Banka Ekonomike gjithmonë kujdeset që klientëve të saj t'u ofrojë shërbime profesionale dhe cilësore bankare, dhe në çdo situatë t'i mbrojtë të dhënat e tyre personale, dhe po ashtu kujdeset për ofrimin e shërbimeve konkurruese bankare. Të gjithë punonjësit e Bankës janë të përkushtuar që t'i njohin klientët e tyre dhe të krijojnë marrëdhënie të besueshme dhe afatgjata me ta, duke u ofruar shërbime profesionale.

Shërbimi ndaj klientit është një nga parimet kryesore mbi bazën e të cilës vepron Banka Ekonomike. Çdo punonjës i Bankës në secilin rast dhe ndaj çdo kërkesë të klientit që ka të bëjë me fushëveprimin e Bankës do të veprojë me mirësjellje, integritet të lartë, profesionalizëm dhe do të ruaj privatësinë dhe të dhënat personale të klientit.

#### **4.4.5. Paanshmëria**

Punonjësit e Bankës do të jenë të paanshëm gjatë kryerjes së detyrave të tyre profesionale dhe do të zbatojnë në mënyrë objektive të drejtat dhe garancitë e të gjitha palëve.

Trajtimi nga punonjësit në mënyrë të paanshme do të zhvillohet pavarësisht përkatësisë kombëtare, racore, gjinore, fetare, paaftësisë fizike, moshës, statusit ekonomik apo interesit politik të personit.

Nëse paraqiten situata të cilat mund të ndikojnë në punonjësin duke shkaktuar tek ai mungesë të paanshmërisë, punonjësi ka për detyrë të informojë mbikëqyrësin e tij direkt apo Departamentin e Pajtuëshmërisë së Përgjithshme.

#### **4.4.6. Paragjykimet**

Stafi do t'i kryejë detyrat e veta pa paragjyqime dhe nuk do të ketë shfaqje të fjalëve apo sjelljeve të paragjykuara bazuar në përkatësinë kombëtare, racore, gjinore, fetare apo statusin ekonomik.

## **5.0. KONFIDENCIALITETI DHE ZBULIMI I INFORMACIONEVE**

Është përgjegjësi e secilit punonjës t'i mbajë të sigurtat informacionet për aktivitetet e Bankës Ekonomike, të klientëve, punëtorëve dhe aksionarëve.

Gjatë punës, punonjësi mund të hasë në informatat që në përgjithësi nuk janë të dedikuara për publikun e gjerë, ndërsa konsiderohen konfidenciale. Kjo mund të përfshijë informatat që kanë lidhje edhe me klientët e tashëm dhe me ata të mëparshëm, furnitorët dhe punonjësit, ose me bankat me të cilat Banka Ekonomike ka lidhje ose ka pasur lidhje në të kaluarën.

Informacionet mund të shpalosen vetëm atëherë kur janë të obliguara me ligj, dhe kur me politika të veçanta janë të rregulluara se kush dhe kur mund të shpalosë të dhëna.

Përjashtimet janë të lejuara vetëm në rastet kur një klient më parë ka dhënë pëlqimin e tij me shkrim, ose në rast se ekzistojnë fakte që përbëjnë një përjashtim të pranuar nga ndalimi i dhënies së informacionit, sidomos përballë autoriteteve mbikëqyrëse dhe autoriteteve të prokurorisë.

Punonjësi i Bankës ka për obligim që çdo informacion që merr nga klientët ta trajtojë me kujdes dhe në mënyrë konfidenciale. Banka është e përkushtuar që të dhënat personale të klientëve të trajtohen në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të aplikueshëm në Kosovë.

Punonjësve të Bankës Ekonomike u ndaloheq të marrin apo të përpiqen të marrin informacionin për të cilin nuk janë të autorizuar ta kenë apo të ketë qasje në të.

Punonjësit të Bankës i ndaloheq të kyçen në llogaritë e punonjësve apo klientëve pa autorizimin e nevojshëm paraprak. Detyra për të ruajtur konfidencialitetin nuk shtrihet vetëm gjatë orarit të punës por edhe jashtë këtij orari.

Konfidencialiteti do të ruhet edhe pasi që stafi nuk do të jetë më i punësuar në Bankën Ekonomike.

### **5.1. Keqpërdorimi i pozitës**

Punonjësve të Bankës u ndaloheq përdorimi i pozitës zyrtare për të fituar privilegje, përjashtime apo përparësi qoftë për veten apo për ndonjë tjetër.

Stafi nuk do të përdorë apo keqpërdorë asetet, dokumentet apo informacionet që i janë besuar për përmbushjen e detyrave profesionale.

Ndaloheq që punonjësit e Bankës të përdorin pozitën në Bankë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për përfitime personale. Kjo nënkupton përdorimin e titullit ose të pozitës së punonjësit (pa dallim të pozitës) për të nënshkruar për produktet, shërbimet ose ndërmarrjet e tjera përveç produkteve dhe shërbimeve të Bankës Ekonomike.

Furnitorët e Bankës Ekonomike nuk lejohen të zgjidhen në bazë të lidhjeve personale.

### **5.2. Konkurrenca**

Banka Ekonomike operon në një ambient gjithnjë e më shumë konkurrues. Në asnjë mënyrë nuk mund të krijohet ndonjë marrëveshje e çfarëdo lloji me ndonjë nga konkurrentet sa u përket çmimeve të shërbimeve.

Nga punonjësit e Bankës pritet që të përmbahen nga deklaratat që vënë në pikëpyetje sjelljen profesionale të konkurrenteve të Bankës Ekonomike.

## **6.0. RAPORTET ME KLIENTIN**

### **6.1. Shërbimi ndaj klientit**

Parimi themelor i Bankës Ekonomike është shërbimi i shkëlqyer ndaj klientëve, andaj ne ofrojmë gjithmonë shërbim cilësor duke përmbushur pritshmërinë e klientëve tanë.

Banka Ekonomike u ofron klientëve të saj produkte dhe shërbime që u përshtaten nevojave të tyre. Gjithçka që ne bëjmë për ta është e bazuar në parimet tona të biznesit.

Kur kemi të bëjmë me klientët duhet të sillemi me nivelet më të larta të integritetit, andaj klientët janë në qendër të strategjisë sonë.

Në Bankën Ekonomike, të gjithë klientët duhet të trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të përshtatshme, pavarësisht nga gjinia, raca, feja, orientimi seksual dhe të ngjashmet.

### **6.2. Produktet dhe proceset**

Banka Ekonomike ofron shërbime dhe produkte në përputhje me kërkesat e klientëve tanë.

Banka Ekonomike, në mënyrë të vazhdueshme, dizajnon dhe rishikon produktet dhe proceset e Bankës në mënyrë që këto t'u përshtaten nevojave të klientëve. Ne mundohemi t'u përgjigjemi me kohë kërkesave të klientëve tanë. Ne u ofrojmë klientëve produkte dhe shërbime varësisht prej nevojave të tyre dhe kapacitetit të tyre financiar.

### 6.3. Transparenca

Qeverisja e mirë korporative kërkon të siguroj që bordi dhe menaxherët të jenë përgjegjës për performancën, dhe në mënyrë që kjo të jetë efikase nevojitet një nivel i arsyeshëm i transparencës. Në të vërtetë, shpresohet që zbatimi i këtij kodi do të ndihmoj të siguroj një shkallë të lartë të transparencës.

Për më tepër, për shkak të ndjeshmërisë dhe përgjegjësisë së saj, Banka duhet të sigurojë transparencë të lartë për të gjitha grupet e interesit lidhur me mënyrën se si e menaxhon paranë, si e drejton biznesin si dhe për shërbimet e ofruara. Për këtë arsye aplikohen rregulla strikte lidhur me publikimin e informatave, ku Banka ka përgjegjësi të sigurojë për publikun informatat adekuate.

Banka Ekonomike u ofron në mënyrë të rregullt informacion të saktë, të qartë dhe transparent klientëve të saj. Banka Ekonomike mban klientët e informuar për të drejtat dhe detyrimet e tyre, për përfitimet dhe rreziqet e produkteve që i ofron.

Të jemi transparent do të thotë të jemi të sinqertë dhe të drejtë me klientët gjatë gjithë kohës. Të qenit transparent nënkupton respektimin e ligjeve, rregullave dhe rregulloreve në fuqi.

### 6.4. Mbrojtja e të dhënave personale

Në mënyrë që Banka dhe të dhënat të mbrohen nga qasja e njerëzve të paautorizuar, konfidencialiteti mbi klientët e biznesit dhe fshehtësitë profesionale, të dhënat e klientëve dhe informatat e tjera të ndjeshme duhet të mbahen në pajtueshmëri me ligjet në Kosovë dhe standardet ndërkombëtare të cilat e rregullojnë këtë çështje. Banka Ekonomike do t'i ndërmarrë masat dhe hapat e nevojshëm për zbatimin e këtyre dispozitave dhe standardeve të pranuar me qëllim të parandalimit të keqpërdorimit të informacionit dhe të dhënave nga njerëz të paautorizuar.

Banka Ekonomike sigurohet se është në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe u ofron siguri klientëve të vet se informatat e tyre personale që i deponojnë në Bankë do të jenë të sigurta dhe nuk do të shpalosen tek palët e treta që nuk janë të autorizuara me ligj që t'i kenë ato.

Misioni i Zyrtarit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale është të sigurojë në baza ditore se secili aktivitet financiar që përfshin përpunimin/mbledhjen e të dhënave personale kryhet në përputhje të plotë me ligjin dhe standardet përkatëse ndërkombëtare mbi mbrojtjen e të dhënave personale.

Çdo informacion personal të klientit ne e mbrojmë dhe e përdorim në mënyrë konfidenciale.

### 6.5. Referimi i klientëve

Ndonjëherë, individë të ndryshëm që i përkasin Bankës mund ta referojnë ndonjë klient të mundshëm. Në asnjë mënyrë punonjësi i Bankës nuk duhet ta trajtojë atë klient në bazë të referimit, kur është fjala për normat e interesit, për shërbime të tjera, ose edhe për ndonjë favor tjetër, që është i ndryshëm me ato favore që u jepen të gjithë klientëve të tjerë.

## 7.0. KONFLIKTI I INTERESIT

Banka Ekonomike ofron një gamë të gjerë të shërbimeve financiare për klientë të ndryshëm. Ajo gjithashtu kryen biznes për llogari të vet. Pasi që konflikti i interesit mund të lindë në rrjedhën normale të biznesit të Bankës në një sërë situatash, njohja e këtyre çështjeve si nga të punësuarit ashtu edhe nga klientët është e një rëndësie të veçantë.

Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare.

### 7.1. Kontributet politike

Banka Ekonomike është një organizatë neutrale politike dhe nuk angazhohet në fushatë politike, parti politike ose në donacione. Banka jonë zhvillon dialog me qeverinë për çështjet që lidhen me biznesin tonë dhe çdo komunikim i ndërmarrë është i sinqertë dhe i saktë.

## 7.2. Trajtimi i konfliktit të interesit për punonjësit e Bankës

Për qëllimet e këtij kodi, konflikti i interesit përkufizohet si përfshirja e çdo punonjësi të Bankës Ekonomike në veprime, si brenda ashtu edhe jashtë Bankës, të cilat bien ndesh me mandatin dhe detyrat e tij. Obligohet çdo punonjës i Bankës ta evitojë menjëherë që çdo veprim apo interes të tij personal i cili mund të bie ndesh me mandatin apo detyrat dhe përgjegjësitë e tij në kuadër të Bankës.

I ndalohet çdo punonjës që të përdorë pozitën e tij me qëllim të marrjes së ndonjë përfitimi për veten e tij apo për ndonjë të afërmi të tij, dhe në çdo rast obligohet që të parandalojë apo shmangë përfshirjen e tij në çfarëdo situatë apo rasti të konfliktit të interesit.

## 7.3. Dhuratat dhe korrupsioni/mitosja

Asnjë punonjës i Bankës Ekonomike nuk do të ofrojë të mira apo dhurata personale që kanë vlerë modeste që mund të kuptohet si përpjekje për të ndikuar në vendimet e klientëve, furnitorit ekzistues ose potencial.

Punonjësit e Bankës mund të japin dhurata vetëm në raste të veçanta, si në rast të festave zyrtare, vetëm nëse dhurata është simbolike dhe që nuk ka qëllime të tjera.

Të gjithë punonjësve të Bankës Ekonomike u ndalohet që të pranojnë dhurata të ndryshme brenda orarit të punës. Pranimi i ndonjë dhurate nga punonjësi mund të konsiderohet si tentim për t'u korruptuar apo për të shfrytëzuar situatën për realizimin e ndonjë qëllimi të caktuar.

Dhuratat ofrohen si mitmarrje për favorizim për të dhënë informata ose për të kryer ndonjë çështje biznesi. Dhuratat janë të ndaluara të pranohen nga personat, nga furnizuesit që bëjnë biznes me ne ose nga klientët e mundshëm (potencialë).

Dhuratat mund të pranohen vetëm në raste të veçanta, si:

- Në rast të festave zyrtare, vetëm nëse dhurata është simbolike dhe që nuk ka qëllime të tjera.
- Drektë zyrtare, që ka të bëjë për çështje biznesi, madje vetëm me miratimin e dhënë paraprakisht.

## 7.4. Prokurimi dhe administrata

Banka kërkon të bëjë prokurimin e ofertave dhe mallrave të kualitetit specifik dhe mundësisht me çmimet më të volitshme. Procesi i prokurimit duhet të bëhet sipas politikave dhe procedurave të brendshme.

Banka nuk do të punojë me ofertuesit që shkelin ligjin ose rrezikojnë reputacionin e Bankës.

## 8.0. SIGURIA DHE VAZHDIMËSIA E BIZNESIT

### 8.1. Ambienti, shëndeti dhe siguria

Banka Ekonomike zhvillon biznesin e vet duke u kujdesur për ambientin, shëndetin dhe sigurinë në përgjithësi.

Banka dhe menaxhmenti do të sigurojë që secili punonjës i Bankës të ketë ambient të punës të sigurt dhe shëndetshëm dhe të zbatohet i gjithë legjislacioni i aplikueshëm që ka të bëjë me mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë.

Banka njih faktin që kjo detyrë kërkon përgjegjësi për të siguruar organizimin, pajisjet, trajnimin dhe mbikëqyrjen e nevojshme në mënyrë që të përmbushet ky obligim.

### 8.2. Vazhdimësia e biznesit

Vazhdimësia e biznesit është jetësore për suksesin tonë si bankë. Kjo na lejon të planifikojmë dhe të përgatitemi për shumëllojshmëri të ndërprerjeve të mundshme të biznesit. Punonjësit i kuptojnë përgjegjësitë e veta për të mbështetur plane specifike për vazhdimin e biznesit.



## 9.0. PARANDALIMI I PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Është politikë e Bankës Ekonomike të veprojë në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Banka Ekonomike është kategorikisht kundër përdorimit të produkteve, shërbimeve dhe aktiviteteve të Bankës për pastrim parash si dhe kundër aktiviteteve të tjera joligjore. Është përgjegjësi e secilit punonjës të Bankës të ndihmojë në sigurimin e pajtueshmërisë me politikat e Bankës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

## 10.0. QËNDRUESHMËRIA

Qëndrueshmëria ka të bëjë me vështirimin e ndikimit afatgjatë të një aktiviteti të biznesit dhe nëse ky ndikim është në mjedis, në shoqëri apo në ekonomi. Kjo do të thotë që ne e konsiderojmë dhe vlerësojmë me kujdes ndikimin që kanë vendimet dhe sjelljet tona në mënyrë direkte dhe indirekte nga këndvështrimi ekonomik, social dhe mjedisor mbi palët tona të interesit. Ne përqipemi të rrisim ndikimin pozitiv për të mbështetur një të ardhme të qëndrueshme për shoqërinë dhe mjedisin.

## 11.0. PUNËSIMI

Mundësitë e barabarta për punësim nënkuptojnë konsideratën e barabartë për një vend pune, që duhet të zbatohet për të gjithë qytetarët, dhe trajtimin e barabartë për të gjithë punonjësit pavarësisht nga gjinia, raca, feja, ngjyra, besimi, përkatësia kombëtare apo paraardhësi, mosha, aftësitë e kufizuara, gjendja martesore, burimi i të ardhurave, pamja fizike, orientimi seksual apo bindjet e tyre politike.

Banka Ekonomike thekson se ofrimi i mundësive të barabarta për punësim në një mjedis të punës jo vetëm që është praktikë e mirë e menaxhimit, por edhe ia jep biznesit një kuptim të shëndoshë. Kjo do t'u ndihmojë të gjithë të punësuarve të zhvillojnë potencialin e tyre të plotë, ndërsa talentet dhe burimet e fuqisë punëtore do të shfrytëzohen për ta ngritur në maksimum efikasitetin e punës së Bankës Ekonomike.

### 11.1. Aktivitetet dhe marrëdhëniet jashtë Bankës Ekonomike

Aktivitetet e punësimit ose marrëdhëniet e tjera jashtë Bankës Ekonomike mund të shkaktojnë konflikt interesash apo mund të dëmtojnë reputacionin e Bankës.

Të gjithë punonjësit e Bankës Ekonomike duhet të kenë kujdes që aktivitetet e tyre jashtë Bankës të mos cenojnë reputacionin e Bankës ose të mos bien ndesh me detyrat tyre në Bankë, dhe paraprakisht të marrin konfirmim sipas politikave të brendshme.

### 11.2. Aktivitetet pas ndërprerjes së punësimit në Bankën Ekonomike

Punonjësit e Bankës Ekonomike nuk duhet të marrin pjesë në kurrfarë aktiviteti të Bankës që prek interesat financiare të ndonjë organizate ose personi ndaj të cilëve kanë shfaqur interesim për punë ose kanë bërë marrëveshje për punësim në të ardhmen.

Ish-punonjësit nuk do të zbulojnë asnjë informatë që konsiderohet konfidenciale nga Banka Ekonomike. Informatat konfidenciale (ato në formë elektronike, të shkruara, gojore ose forma të tjera) nuk duhet të dalin jashtë godinave të Bankës.

## 12.0. SHKELJET E KODIT TË MIRËSJELLJES

### 12.1. Detyrimi për t'i raportuar shkeljet

Banka Ekonomike inkurajon dhe obligon punonjësit që të raportojnë shkeljet e Kodit të Mirësjelljes dhe gjithashtu inkurajon edhe klientët që të raportojnë nëse ky Kod i Mirësjelljes shkelet gjatë marrëdhënies biznesore me ta për çështjet e Bankës.

Raportimet mund të bëhen në çdo formë të mundshme komunikimi, përfshirë raportet e shkruara anonime por edhe në emailin [whistleblowing@bekonomike.com](mailto:whistleblowing@bekonomike.com).